



Instruktionet e
përdorimit

Quality, Design and Innovation





home.liebherr.com/fridge-manuals



LIEBHERR





Përmbajtja




1	Informacione për sigurinë dhe paralajmërime.....	3
1.1	Përdorimi i parashikuar.....	3
1.2	Klasat e klimës.....	3
1.3	Grupi i përdoruesve.....	3
1.4	Instalimi dhe vënia në punë.....	3
1.5	Trajtimi i sigurt i pajisjes.....	3
1.6	Pastrimi.....	4
1.7	Defektet, dëmtimet dhe riparimet.....	4
1.8	Hedhja.....	4
1.9	Konformiteti.....	4
1.10	Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH.....	4
1.11	Baza e të dhënave EPREL.....	4
1.12	Licencat me burim të hapur.....	4
1.13	Pjesët e këmbimit.....	4
1.14	Simbolet në pajisje.....	4
1.15	Nivelet e paralajmërimit.....	5
2	Pajisja në një vështrim të shpejtë.....	5
2.1	Përmbajtja e dërgesës.....	5
2.2	Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve.....	5
2.3	SmartDevice.....	5
3	Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe.	5
3.1	Navigimi dhe shpjegimi i simboleve.....	5
3.2	Menytë.....	6
3.3	Modaliteti i qetësisë.....	7
4	Vënia në punë.....	7
4.1	Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë).....	7
5	Ruajtja.....	7
5.1	Udhëzime për ruajtjen.....	7
5.2	Dhoma e ngrirjes.....	7
5.3	Kohët e ruajtjes.....	8
6	Kursimi i energjisë.....	8
7	Përdorimi.....	8
7.1	Elementët e komandimit dhe tregues.....	8
7.1.1	Treguesi i statusit.....	8
7.1.2	Simbolet treguese.....	8
7.2	Funksionet e pajisjes.....	9
7.2.1	Udhëzime për funksionet e pajisjes.....	9
	Fikja dhe ndezja e pajisjes.....	9
	WLAN.....	9
	Temperatura.....	10
	Njësia e temperaturës.....	10
	SuperFrost.....	11
	Nisja e ciklit të shkrirjes.....	11
	SabbathMode.....	12
	EnergySaver.....	12
	Niveli i dritës së ekranit.....	13
	Alarmi i derës.....	13
	Blokim i panelit.....	13



Gjuha.....	14
Informacioni i pajisjes.....	14
Software.....	14
Modaliteti i demonstrimit.....	14
Rikthimi në cilësimet nga fabrika.....	15
7.3 Mesazhet.....	16
7.3.1 Përmbledhje e paralajmërimeve.....	16
7.3.2 Mënjanimi i paralajmërimeve.....	16
7.3.3 Përmbledhje e kujtesave.....	17
8 Pajisjet.....	17
8.1 Sirtarët.....	17
8.2 Forma me kapak e kubave të akullit.....	17
9 Mirëmbajtja.....	18
9.1 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje.....	18
9.2 Shkrirja e pajisjes.....	21
9.3 Pastrimi i pajisjes.....	21
10 Ndhim për klientin.....	21
10.1 Të dhënat teknike.....	21
10.2 Zhurmat gjatë punës.....	22
10.3 Defektet teknike.....	22
10.4 Shërbimi për klientin.....	23
10.5 Etiketa e parametrave.....	23
11 Nxjerrja jashtë pune.....	23
12 Hedhja.....	24
12.1 Përgatitja e pajisjes për mënjanimin.....	24
12.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike.....	24

Prodhuesi punon në vazhdimësi për zhvillimin e mëtejshëm të të gjitha llojeve dhe modeleve. Për këtë arsye, lutemi në mirëkuptimin tuaj që ne duhet të rezervojmë të drejtën e ndryshimeve në formë, pajisje dhe teknologji.

Simboli	Shpjegimi
	<p>Lexoni manualin e instruksioneve</p> <p>Për t'u njohur me të gjitha avantazhet e pajisjes suaj të re, ku lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet në këtë manual instruksionesh.</p>
	<p>Informacionet plotësuese në internet</p> <p>Manualin dixhital me informacionet plotësuese dhe në gjuhë të tjera e gjeni në internet nëpërmjet kodit QR në kopertinën e këtij manuali ose duke futur numrin e servisit në adresën home.liebherr.com/fridge-manuals.</p> <p>Numrin e servisit e gjeni në etiketën e parametrave:</p>  <p style="text-align: right;"><i>Fig. Shembull ilustrues</i></p>
	<p>Kontrolli i pajisjes</p> <p>Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtoheni te shitësi ose te kujdesi për klientin.</p>

Simboli	Shpjegimi
	Ndryshimet Manuali është i vlefshëm për disa modele, kështu që mund të ketë ndryshime. Seksionet që kanë të bëjnë vetëm me pajisje të caktuara janë të shënuara me një yll (*).
	Udhëzimet e veprimeve dhe rezultatet e veprimeve Udhëzimet e veprimeve janë të shënuara me një ▶. Rezultatet e veprimeve janë të shënuara me një ▷.
	Videot Videot për pajisjet ofrohen në kanalën në YouTube të kompanisë Liebherr-Hausgeräte.

Licencat me burim të hapur:

Pajisja përmban komponentë softuerikë që përdorin licenca me burim të hapur. Informacionet për licencat me burim të hapur që janë përdorur mund t'i gjeni këtu: home.liebherr.com/open-source-licences

Ky manual përdorimi vlen për:

SUFNPc	365i
--------	------

1 Informacione për sigurinë dhe paralajmërime

Ruajini me kujdes këto informacione për përdoruesin, për t'i pasur në dispozicion në çdo kohë.

Nëse ia kalojmë pajisjen dikujt tjetër, kalojini prangat të radhës edhe këto informacione për përdoruesin.

Për ta përdorur pajisjen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, lexoni me kujdes këto informacione për përdoruesin përpara instalimit dhe përdorimit të pajisjes. Ndiqni gjithmonë instruksionet që ato përmbajnë, udhëzimet e sigurisë dhe udhëzimet paralajmëruese. Ato janë të rëndësishme, në mënyrë që ta instaloni dhe ta përdorni pajisjen në mënyrë të sigurt dhe të saktë.

1.1 Përdorimi i parashikuar

- Kjo pajisje është parashikuar për përdorim në shtëpi dhe në ambiente të ngjashme, si për shembull:
 - në kuzhinat e personelit në dyqane, në zyrat dhe ambiente të tjera pune
 - në mjedise bujqësore dhe nga vizitorë në hotele, motele dhe strehime të tjera
 - në mensat e mëngjesit
 - në shërbimin katering dhe përdorime të ngjashme në tregtinë me shumicë
- Përdorime të tjera:
 - Kjo pajisje është e përshtatshme për montim të integruar nën banak.
 - Të gjitha llojet e tjera të përdorimit konsiderohen të palejuara.

1.2 Klasat e klimës

Pajisja është projektuar sipas klasave të klimës për përdorimin në temperatura mjedisi të kufizuara. Klasa përkatëse e klimës për pajisjen tuaj është e stampuar në etiketën e parametrave.

Shënim

- ▶ Për të garantuar një përdorim pa probleme të pajisjes, respektoni temperaturat e dhëna të ambientit.

Klasa e klimës	për temperaturat e ambientit nga
SN (Subnormale)	10 °C deri në 32 °C
N (Normale)	16 °C deri në 32 °C
ST (Subtropikale)	16 °C deri në 38 °C
T (Tropikale)	16 °C deri në 43 °C
SN-ST	10 °C deri në 38 °C
SN-T	10 °C deri në 43 °C

1.3 Grupi i përdoruesve

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e lart dhe nga personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo me mungesë përvojë dhe njohurish, kur ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe ata i kuptojnë rreziqet që rezultojnë prej saj.
- Nuk lejohet që fëmijët të luajnë me pajisjen.
- Fëmijët nuk duhen të pastrojnë ose të kryejnë procese mirëmbajtëse nga ana e përdoruesit në pajisje.
- Fëmijët e moshës 3-8-vjeçare lejohen të mbushin dhe të zbrazin pajisjen.

1.4 Instalimi dhe vënia në punë

- Montojeni dhe lidheni pajisjen vetëm sipas udhëzimeve në informacionin për përdoruesin.
- Montojeni pajisjen sipas udhëzimeve në informacionin për përdoruesin, për të shmangur animin e pajisjes.
- Mos mbyllni vrimat e ajrimit në trupin e pajisjes ose në folenë e montimit.
- Mos e dëmtoni kabllin e rrjetit. Mos e vini në punë pajisjen me kabëll rrjeti të dëmtuar.
- Mos vendosni priza të lëvizshme të shumëfishta ose adaptorë në pjesën e pasme të pajisjes.
- Priza elektrike duhet të jetë lehtësisht e arritshme, në mënyrë që pajisja të shkëputet shpejt nga energjia elektrike në rast emergjence. Ajo duhet të ndodhet jashtë zonës së pjesës së pasme të pajisjes.

1.5 Trajtimi i sigurt i pajisjes

- Mos ruani në pajisje lëndë me aftësi shpërthyes, si për shembull kanaçe aerosol me gaz shtytës të djegshëm. Kanaçet spërkatëse përkatëse identifikohen tek të dhënat e printuara të përmbajtjes ose nga një simbol flake. Gazet që mund të kenë rrjedhur mund të ndizen nga pjesët elektrike.
- Mbani larg nga pajisja qirinjte e ndezur, llambat ose objektet e tjera me flakë të zbuluar, në mënyrë që këto të mos i vënë flakën pajisjes.
- Pijet alkoolike ose paketimet e tjera që përmbajnë alkool vendosini në ruajtje të mbyllura në mënyrë hermetike. Alkooli që mund të kenë rrjedhur mund të ndizet nga pjesët elektrike.
- Shmangni kontaktin e zgjatur të lëkurës me sipërfaqet e ftohta ose ushqimet e ftohta/ngrira. Për mbrojtjen, përdorni p.sh., doreza.
- Gazi ftohës i pajisjes (specifikimet në etiketën e parametrave) është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës që rrjedh mund të marrë flakë.
 - Mos e dëmtoni qarkun e ftohjes.

Informacione për sigurinë dhe paralajmërimet

- Në pjesën e brendshme të pajisjes mos përdorni burime ndezëse.
- Në pjesën e brendshme të pajisjes mos përdorni pajisje elektrike (p.sh. pajisje pastrimi me avull, pajisje ngrohëse).
- Nëse ka rrjedhje të gazit ftohës: Mënjaroni flakën e zbuluar ose burimet e ndezjes në afërsi të vendit të rrjedhjes. Ajrosni mirë dhomën. Njoftoni shërbimin e klientit.
- Hapeni derën vetëm për kohë të shkurtra. Në këtë mënyrë shmangni rritjen e temperaturës në brendësi të pajisjes.
- Mos i futni duart midis derës dhe pajisjes gjatë hapjes dhe mbylljes së derës. Gishtat mund të kapen aty.
- Vlera e temperaturës në zonën më të ngrohtë të pajisjes mund të jetë më e lartë se vlera e vendosur e temperaturës.

1.6 Pastrimi

- Pastroni rregullisht sipërfaqet që bien në kontakt me ushqimet.
- Pastroni rregullisht largimin e ujit të shkrirjes.
- Për përsheptimin e procesit të shkrirjes mos përdorni asnjë pajisje ngrohëse elektrike ose pajisje pastrimi me avull, flakë të zbuluara ose spërkatës për shkrirje.
- Mos e hiqni akullin me objekte të mprehta.

1.7 Defektet, dëmtimet dhe riparimet

- Kur kabllin e rrjetit të pajisjes dëmtohet, ndërrojeni atë.
- Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje lejohen të kryhet vetëm nga shërbimi i klientit ose nga staf tjetër teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- Kur ka dëmtime ose defekte në pajisje, hiqni spinën e rrjetit ose fikni siguresën. Kur tërhiqet spina e rrjetit, kapeni gjithmonë nga spina. Mos e tërhiqni nga kabllin.

1.8 Hedhja

- Pajisja përmban materiale të vlefshme dhe është shënuar me një simbol përkatës. (shihni 1.14 Simbolet në pajisje)
 - Mos e hidhni pajisjen në mbeturinat shtëpiake.
 - Hidhni pajisjen pa pagesë në pikat lokale të riciklimit dhe të mbledhjes së materialeve të ripërdorshme, në koshat e grumbullimit të klasës 1.
 - Kur blini një pajisje të re, pajisjen e vjetër kthejeni në dyqan pa pagesë.
 - Informohuni lidhur me mundësitë e kthimit.
- Në pajisjen tuaj mund të gjenden të dhëna personale.
 - Fshijini të dhënat personale para se ta hidhni pajisjen.
- Pajisja përmban një gaz ftohës (specifikimet në etiketën e parametrave) dhe vaj. Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkatës dhe në kontakt me një burim nxehtësie të jashtëm.
 - Mos dëmtoni qarkun e ftohjes.
 - Hidhni pajisjen vetëm sipas udhëzimeve në informacionin për përdoruesin.

1.9 Konformiteti

Qarku i gazit ftohës është testuar për rrjedhje. Në gjendje të montuar, pajisja është në përputhje me dispozitat përkatëse të sigurisë dhe me rregulloret përkatëse.

Për tregun e BE- Pajisja është në përputhje me së: Direktivën 2014/53/BE.

Për tregun në GB: Pajisja është në përputhje me Radio Equipment Regulations 2017 SI 2017 No. 1206.

Teksti i plotë i deklaratës EU të konformitetit disponohet në adresën e mëposhtme të internetit: www.Liebherr.com

1.10 Substancat me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) sipas rregullores REACH

- Në lidhjen në vijim mund të kontrolloni nëse pajisja juaj përmban substanca SVHC, në kuptim të rregullores REACH:
home.liebherr.com/de/deu/de/liebherr-erleben/nachhaltigkeit/umwelt/scip/scip.html

1.11 Baza e të dhënave EPREL

- Nga data 1 mars 2021, informacionet për etiketimin e konsumit të energjisë dhe për kërkesat e dizajnit ekologjik do të disponohen në bazën evropiane të të dhënave të produkteve (EPREL). Në lidhjen e mëposhtme <https://eprel.ec.europa.eu/> shkoni te baza e të dhënave të produkteve. Këtu kërkohet që të vendosni emërtimin e modelit. Emërtimin e modelit e gjeni në etiketën e parametrave të produktit.

1.12 Licencat me burim të hapur

- Pajisja përmban komponentë softuerikë që përdorin licenca me burim të hapur. Informacionet për licencat me burim të hapur që janë përdorur mund t'i gjeni këtu: home.liebherr.com/open-source-licences




1.13 Pjesët e këmbimit

- Disponueshmëria e pjesëve të këmbimit për pjesët funksionale dhe pjesët me kapacitet ruajtës të pajimit është 15 vjet.

1.14 Simbolet në pajisje

	Ky simbol mund të gjendet mbi kompresor. Ai ka të bëjë me vajin në kompresor dhe jep udhëzim për rrezikun e mëposhtëm: Mund të jetë fatal në rast gëlltijeje ose futjeje në rrugët e frymëmarrjes. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Në gjendje pune normale nuk ekziston asnjë rrezik. Mos e hiqni këtë simbol.
	Paralajmërim: Rrezik zjarri nga lëndë të djegshme. Ky simbol ndodhet në kompresor, por mund të ndodhet edhe në vende të tjera në pajisje. Ky simbol paralajmëron për lëndë të djegshme. Mos e hiqni këtë simbol.
	Ky simbol ose një i ngjashëm me të mund të ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes. Ai tregon se te dera dhe/ose tek trupi ka panele izoluese me vakuum (VIP) ose panele me perlit. Ky udhëzim është i rëndësishëm vetëm për riciklimin. Mos e hiqni këtë simbol.
	Ky simbol gjendet mbi etiketën e parametrave. Ai tregon se pajisja përmban materiale të vlefshme dhe nuk duhet ta hidhni atë me mbeturinat shtëpiake. (shihni 1.8 Hedhja)

1.15 Nivelet e paralajmërimit

 RREZIK	Identifikon një situatë të rrezikshme të drejtpërdrejtë, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohen.
 PARALAJMËRIM	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila ka si pasojë vdekjen ose lëndime të rënda fizike, nëse nuk mënjanohen.
 VINI RE	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila ka si pasojë lëndime të lehta ose mesatare fizike, nëse nuk mënjanohen.
KUJDES	Identifikon një situatë të rrezikshme, e cila mund të ketë si pasojë dëme materiale, nëse nuk mënjanohet.
Shënim	Identifikon udhëzimet dhe këshillat e dobishme.

2 Pajisja në një vështrim të shpejtë

2.1 Përmbajtja e dërgesës

Kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti. Në rast ankesash drejtohuni te shitësi ose te shërbimi për klientin. (shihni 10.4 Shërbimi për klientin)

Dërgesa përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- Pajisje inkaso
- Pajisjet (në varësi nga modeli)
- Materiali i montimit (në varësi nga modeli)
- „Quick Start Guide“
- „Installation Guide“*
- Broshura e shërbimit

2.2 Pasqyra e pajisjes dhe pjesëve




Fig. 1 Shembull ilustrues

Pajisjet

- | | |
|--|---------------------------------|
| (1) Etiketa e parametrave | (5) Sirtari |
| (2) Këmba me rregullim | (6) Largimi i ujit të shkrirjes |
| (3) Elementët e komandimit dhe treguesi i temperaturës | (7) Koshi me tërheqje |
| (4) Ndriçimi i brendshëm* | |

Shënim

Nëse pajisja juaj ka një N në emërtimin e pajisjes, atëherë bëhet fjalë për një pajisje NoFrost.

2.3 SmartDevice

SmartDevice është zgjidhja e lidhjes në rrjet për frigoriferin tuaj ngrirës.

Nëse pajisja juaj mbështet SmartDevice ose është përgatitur për të, ju mund ta lidhni pajisjen shpejt dhe thjeshtë në rrjetin tuaj WLAN. Me aplikacionin SmartDevice mund ta komandoni pajisjen tuaj nga një pajisje fundore celulare. Në aplikacionin SmartDevice keni në dispozicion funksione shtesë dhe mundësi rregullimi.

Pajisja mbështet SmartDevice: që Pajisja juaj mbështet SmartDevice. Për ta lidhur pajisjen tuaj me rrjetin WLAN, duhet që të shkarkoni aplikacionin SmartDevice.

Informacione tjera për SmartDevice: të smartdevice.liebherr.com

Shkarkoni aplikacionin SmartDevice:



Pas instalimit dhe konfigurimit të aplikacionit SmartDevice mund ta lidhni pajisjen tuaj me ndihmën e aplikacionit SmartDevice dhe të funksionit të pajisjes WLAN (shihni WLAN).

Shënim

Funksioni SmartDevice nuk ofrohet në shtetet e mëposhtme: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan.

3 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe

Ju e përdorni pajisjen me anë të ekranit Touch & Swipe. Me ekranin Touch & Swipe (në vijim referuar si ekran) ju zgjidhni funksionet e pajisjes duke prekur mbi ekran ose duke rrëshqitur me gisht në ekran. Nëse për 10 sekonda nuk kryeni asnjë veprim në ekran, treguesi i ekranit kthehet ose te menyuja e një niveli më lart, ose kthehet direkt tek treguesi i statusit.

3.1 Navigimi dhe shpjegimi i simboleve

Në figura përdoren simbole të ndryshme për navigimin në ekran. Këto simbole përshkruhen në tabelën në vijim.

3.3 Modaliteti i qetësisë

Nëse nuk e prekni ekranin për 1 minutë, atëherë ekranin kalon në modalitetin e qetësisë. Në modalitetin e qetësisë, niveli i dritës së treguesit është i errësuar.

3.3.1 Përfundimi i modalitetit të qetësisë

- ▶ Prekni shkurt ekranin me gisht.
- ▶ Modaliteti i qetësisë përfundon.

4 Vënia në punë

4.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë)

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Pajisja është montuar dhe lidhur në përputhje me instruksionet e montimit.
- Të gjithë shiritat ngjitës, fletët ngjitëse dhe mbrojtëse, si dhe sigureset e transportit brenda dhe jashtë pajisjes janë hequr.
- Të gjitha fletëpalosjet e reklamave janë hequr nga sirtarët.
- Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe është e njohur. (shihni 3 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)

Ndezja e pajisjes përmes ekranit Touch & Swipe:

- ▶ Kur ekranin është në modalitetin e qetësisë: Prekni shkurt ekranin.
- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.




Fig. 5 Shembull ilustrues

- ▶ Shfaqet treguesi i statusit.
- ▶ Pajisja ftohet në temperaturën e synuar të vendosur nga fabrika.
- ▶ Pajisja ndizet në modalitetin demonstrativ (treguesi i statusit shfaqet me DEMO): Nëse pajisja ndizet në modalitetin demonstrativ, atëherë ju mund ta çaktivizoni modalitetin demonstrativ brenda 5 minutave. (shihni Modaliteti i demonstrimit)

Informacione të tjera:

- Vini në funksionim SmartDevice. (shihni 2.3 SmartDevice) dhe (shihni WLAN)

Shënim

Prodhuesi këshillon:

- ▶ Futni **ushqimet për ngrirje** në -18 °C ose më shumë.
- ▶ Ndiqui udhëzimet për ruajtjen. (shihni 5.1 Udhëzime për ruajtjen)

Shënim

Aksesorët mund t'i blini në dyqanin Liebherr-Hausgeräte në adresën e internetit home.liebherr.com/shop/de/deu/zubehor.html.

5 Ruajtja

5.1 Udhëzime për ruajtjen



PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri nga pajisjet elektrike!

Përdorimi i pajisjeve elektrike në zonën e ushqimeve mund të shkaktojë rënie zjarri.

- ▶ Mos përdorni pajisje elektrike në zonën e ushqimeve të pajisjes, nëse kjo nuk rekomandohet nga prodhuesi.

Shënim

Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.

- ▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit.

Ndiqui specifikimet e mëposhtme për ruajtjen:

- Paketoni mirë ushqimet.
- Paketoni në enë/kuti të mbyllur e të pastër mishin ose peshkun e pagatuar. Në këtë mënyrë parandaloni që mishi ose peshku të prekin ushqimet e tjera ose që të pikojnë sipër tyre.
- Ruani lëngjet në enë të mbyllura.
- Vendosni ushqimet me distancë nga njëra-tjetra, me qëllim që ajri të mund të qarkullojë mirë.
- Vendosni ushqimet në ruajtje në përputhje me specifikimet në paketim.
- Mbani gjithmonë parasysh datën e dhënë për afatin e përdorimit, e cila ndodhet në paketim.

Shënim

Mosndjekja e këtyre këshillave mund të rezultojë në prishjen e ushqimeve.

5.2 Dhoma e ngrirjes

Në -18 °C këtu krijohet një klimë ruajtjeje e akullit e thatë. Një klimë e akullit e ruajtjes është e përshtatshme për ruajtjen për disa muaj të ushqimeve të ngrira dhe të artikujve në ngrirje, për prodhimin e kubave të akullit ose për ngrirjen e ushqimeve të freskëta.

5.2.1 Ngrirja e ushqimeve

Sasia për ngrirje

Ju mund të ngrini maksimumi aq ushqime të freskëta brenda 24 orëve sa tregohet në etiketën e parametrave (shihni 10.5 Etiketa e parametrave) në pjesën "Kapaciteti i ngrirjes ... kg/24h".

Me qëllim që ushqimi të ftohet shpejt deri në brendësi, respektoni sasinë e mëposhtme për çdo paketim:

- Fruta dhe perime deri në 1 kg
- Mish deri në 2,5 kg

Ngrirja e ushqimeve me SuperFrost

Në varësi të sasisë për ngrirje, përpara ngrirjes ju mund të aktivizoni funksionin SuperFrost, në mënyrë që të arrihen temperatura të ngrirjes së thellë. (shihni SuperFrost)

- ▶ Aktivizoni SuperFrost, kur sasia për ngrirje është më e madhe se rreth 2 kg.

Momenti në të cilin aktivizoni funksionin SuperFrost varet nga sasia për ngrirje:

Kursimi i energjisë

Sasia për ngrirje	Momenti për aktivizimin e funksionit SuperFrost
Sasi e vogël për ngrirje	Aktivizoni funksionin SuperFrost rreth 6 orë përpara ngrirjes. Sapo pajisja ta çaktivizojë automatikisht funksionin SuperFrost, mund të riorganizoni ushqimet.
Sasi maksimale për ngrirje	Aktivizoni funksionin SuperFrost rreth 24 orë përpara ngrirjes. Sapo pajisja ta çaktivizojë automatikisht funksionin SuperFrost, mund të riorganizoni ushqimet.

Sistemimi i ushqimeve



VINI RE

Rrezik lëndimi nga thyerja e qelqit!
Shishet dhe kanaçet me pije mund të plasën nga ngrirja. Kjo vlen në mënyrë të veçantë për pijet që përmbajnë gaz karbonik.

► Ngrijini shishet dhe kanaçet me pije vetëm nëse keni aktivizuar funksionin BottleTimer në aplikacionin SmartDevice.

Sasia për ngrirje	Sistemimi i ushqimeve
Sasi e vogël për ngrirje	Shpërndajini ushqimet e paketuara njëtrajtshmërisht në pajisje. Nëse është e mundur, sistemojini ushqimet afër faqes së pasme.
Sasi maksimale për ngrirje	Shpërndajini ushqimet e paketuara njëtrajtshmërisht në pajisje. Nëse është e mundur, sistemojini ushqimet afër faqes së pasme.

5.2.2 Shkrirja e ushqimeve



PARALAJMËRIM

Rrezik i helmimit nga ushqimi!
► Mos i ngrini më përsëri ushqimet e shkrira.
► Gatvani ushqimet e shkrira sa më shpejt të jetë e mundur.

Ju mund t'i shkrini ushqimet në mënyra të ndryshme:

- në një frigorifer freskues
- në mikrovalë
- në furrë/sobë me ajër të nxehtë
- në temperaturë ambienti

► Nxirrni nga frigoriferi vetëm aq ushqim sa ju nevojitet.

5.3 Kohët e ruajtjes

Kohët e treguara të ruajtjes janë vlera orientuese.

Për ushqimet me specifikim të afatit të përdorimit vlen gjithmonë data e përcaktuar në paketim.

Vlerat orientuese për ruajtjen e ushqimeve të ndryshme		
Akullore	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Sallame, proshuta	në -18 °C	2 deri në 3 muaj
Bukë, produkte brumi për pjekje	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Mish i egër, mish derri	në -18 °C	6 deri në 9 muaj
Peshk, me yndyrë	në -18 °C	2 deri në 6 muaj

Vlerat orientuese për ruajtjen e ushqimeve të ndryshme		
Peshk, pa yndyrë	në -18 °C	6 deri në 8 muaj
Djathë	në -18 °C	2 deri në 6 muaj
Shpendë, mish gjedhi	në -18 °C	6 deri në 12 muaj
Perime, fruta	në -18 °C	6 deri në 12 muaj

6 Kursimi i energjisë

- Kujdesuni gjithmonë për qarkullimin e mirë të ajrit dhe për ajrimin. Mos i mbulonit vrimat ose grilat e ajrimit.
- Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit.
- Mos e montoni pajisjen as në një vend në rrezet direkte të diellit, as pranë sistemit të ngrohjes apo të ngjashme.
- Kur e montoni pajisjen direkt ngjitur me një furrë, konsumi i energjisë mund të rritet paksa. Kjo varet nga kohëzgjatja e përdorimit dhe nga intensiteti i përdorimit të furrës.
- Konsumi i energjisë varet nga kushtet e instalimit, për shembull nga temperatura e ambientit. Kur temperatura e ambientit është më e ngrohtë, atëherë konsumi i energjisë mund të rritet.
- Hapeni pajisjen mundësisht sa më pak kohë.
- Sa më e ulët të vendoset temperatura, aq më i lartë do të jetë konsumi i energjisë.
- Të gjitha ushqimet vendosini në ruajtje të paketuara mirë dhe të mbuluara. Kështu shmanget formimi i akullit/borës.
- Futja e ushqimeve të ngrohta: në fillim lërinë të ftohen në temperaturën e dhomës.

7 Përdorimi

7.1 Elementët e komandimit dhe tregues

7.1.1 Treguesi i statusit






Fig. 6 Treguesi i statusit tregon temperaturën aktuale.

(1) Treguesi i temperaturës

7.1.2 Simbolet treguese

Simbolet treguese janë informacion rreth gjendjes aktuale të pajisjes.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	Standby Pajisja ose zona e temperaturës është e fikur.
	Numër që pulson Pajisja është duke punuar. Temperatura pulson derisa të arrihet vlera e vendosur.

Simboli	Gjendja e pajisjes
	Simbol që pulson Pajisja është duke punuar. Rregullimi po pranohet.
	

7.2 Funksonet e pajisjes

7.2.1 Udhëzime për funksionet e pajisjes

Funksionet e pajisjes janë konfiguruar në mënyrë të tillë nga fabrika që pajisja juaj të jetë plotësisht funksionale.

Përpara se të ndryshoni, të aktivizoni ose të çaktivizoni funksionet e pajisjes, sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Ju keni lexuar dhe keni kuptuar përshkrimet për mënyrën e funksionimit të ekranit. (shihni 3 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)
- Ju jeni familjarizuar me elementët e komandimit dhe elementët tregues të pajisjes suaj.

Fikja dhe ndezja e pajisjes

Me këtë funksion ju fikni dhe ndizni të gjithë pajisjen.

Fikja e pajisjes

Kur fikni pajisjen, atëherë të gjitha rregullimet e kryera më parë do të ruhen.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Janë ndjekur të gjitha udhëzimet e veprimeve (shihni 11 Nxjerrja jashtë pune).



Fig. 7




Fig. 8

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Pajisja fiket.
- Në ekran shfaqet simboli Standby.
- Ekran i bëhet i zi.

Ndezja e pajisjes

- Kur ekran i ndodhet në modalitetin e qetësisë:
- Prekni shkurt ekranin.




Fig. 9 Shembull ilustrues

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Kur pajisja ndizet në modalitetin e demonstrimit:
- Çaktivizoni modalitetin e demonstrimit. (shihni Çaktivizimi i modalitetit të demonstrimit)
- Pajisja do të ndizet.
- Rregullimet e kryera më parë do të rivendosen.
- Pajisja ftohet në temperaturën e synuar të vendosur.

WLAN

Me këtë funksion ju lidhni pajisjen tuaj me rrjetin WLAN. Atë mund ta komandoni më pas përmes aplikacionit SmartDevice nga një pajisje fundore celulare. Me këtë funksion ju mund të ndani përsëri ose të rivendosni lidhjen në rrjetin WLAN.

Informacione të tjera për SmartDevice: (shihni 2.3 SmartDevice)

Shënim

Funksioni SmartDevice nuk ofrohet në shtetet e mëposhtme: Rusi, Bjellorusi, Kazakistan.

Realizimi i lidhjes me WLAN herën e parë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Aplikacioni SmartDevice është instaluar (shihni apps.home.liebherr.com).
- Regjistrimi në aplikacionin SmartDevice ka përfunduar.



Fig. 10




Fig. 11

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Lidhja është vendosur.

Përdorimi

Shkëputja e lidhjes me WLAN



Fig. 12




Fig. 13

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Lidhja është shkëputur.

Rivendosja e lidhjes me WLAN




Fig. 14




Fig. 15

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Lidhja me WLAN dhe rregullimet e tjera të WLAN rikthehen në cilësimet nga fabrika.

Shfaqja e informacioneve për lidhjen me WLAN




Fig. 16




Fig. 17

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-18°C Temperatura

Me këtë funksion ju vendosni temperaturën.

Temperatura varet nga faktorët e mëposhtëm:

- shpeshësia e hapjes së derës
- kohëzgjatja e hapjes së derës
- temperatura e dhomës në vendin e instalimit
- lloji, temperatura dhe sasia e ushqimit

Dhoma e ngrirjes	Temperatura e vendosur nga fabrika	Cilësimi rekomanduar
-18°C	-18 °C	-18 °C

Vendosja e temperaturës




Fig. 18 Shembull ilustrues

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Temperatura vendoset.

°C/°F Njësia e temperaturës

Me këtë funksion ju vendosni njësinë e temperaturës. Ju mund të vendosni gradë Celsius ose gradë Fahrenheit si njësi të temperaturës.

Vendosja e njësisë së temperaturës



Fig. 19




Fig. 21 Shembull ilustrues: Ndërimi nga gradë Celsius në gradë Fahrenheit.

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ Njësia e temperaturës do të vendoset.

SuperFrost

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni SuperFrost. Kur aktivizoni funksionin SuperFrost, atëherë pajisja e përforcon kapacitetin e ngrirjes. Si rezultat arrini temperatura ngrirjeje më të thella.

Përdorimi:

- Ushqimet e freskëta ngrijnë shpejt deri në brendësi. Kjo siguron që të ruhen vlerat ushqyese, pamja dhe shija e ushqimeve.
- Rritni rezervat e ftohjes në ushqimet e ruajtura në ngrirje, përpara se të shkrini pajisjen.

Kur funksioni është aktiv, atëherë pajisja punon me kapacitet më të lartë. Si rezultat, zhurmat e punës së pajisjes mund të jenë më të larta se zakonisht dhe konsumi i energjisë rritet.

Aktivizimi i SuperFrost

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Sasia e produkteve për ngrirje dhe momenti për aktivizimin e funksionit SuperFrost janë marrë parasysh. (shihni Ngrirja e ushqimeve me SuperFrost)



Fig. 22




Fig. 23

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

- ▶ Aktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

- ▶ SuperFrost aktivizohet.
- ▶ Treguesi i temperaturës bëhet blu.

Çaktivizimi i SuperFrost

Në varësi nga sasia e ushqimeve të vendosura, SuperFrost çaktivizohet automatikisht pas 56 deri në 72 orë. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni funksionin SuperFrost edhe manualisht në çdo kohë:



Fig. 24




Fig. 25

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

- ▶ Çaktivizojeni me aplikacionin SmartDevice.

- ▶ SuperFrost do të çaktivizohet.
- ▶ Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.
- ▶ Pajisja ftoh në temperaturën e vendosur më parë.



Nisja e ciklit të shkrirjes

Me këtë funksion ju nisni manualisht ciklin e shkrirjes automatike, kur cikli i shkrirjes nuk fillon automatikisht në rast të një defekti.

Nisja e ciklit të shkrirjes



Fig. 26




Fig. 27

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ Cikli i shkrirjes ka nisur: Simboli pulson derisa cikli i shkrirjes të përfundojë automatikisht.
- ▶ Kur cikli i shkrirjes ka përfunduar: Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.

Anulimi i ciklit të shkrirjes

Cikli i shkrirjes përfundon automatikisht. Megjithatë, ju mund ta anuloni gjithashtu ciklin e shkrirjes në çdo kohë gjatë procesit të shkrirjes:




Fig. 28

Përdorimi

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ Cikli i shkrirjes ndërpritet.
- ▶ Pajisja vazhdon punën në funksionim normal.



SabbathMode

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni SabbathMode. Kur e aktivizoni këtë funksion, disa funksione elektronike do të çaktivizohen. Në këtë mënyrë, pajisja juaj përmbush kërkesat fetare për festat hebraike, si për shembull në Shabat dhe plotëson certifikimin STAR-K Kosher.

Gjendja e pajisjes me SabbathMode aktiv
Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode.
Të gjitha funksionet në ekran përveç funksionit Çaktivizimi i SabbathMode janë të bllokuara.
Të gjitha funksionet mbeten aktive.
Ekrani qëndron i ndriçuar kur mbyllni derën.
Ndriçimi i brendshëm është i çaktivizuar.
Kujtesat nuk ekzekutohen. Intervali kohor i vendosur ndalohe.
Kujtesat dhe paralajmërimet nuk shfaqen.
Nuk ka asnjë alarm të derës.
Nuk ka asnjë alarm të temperaturës.
Cikli i shkrirjes punon vetëm sipas kohës së paracaktuar, pa marrë parasysh përdorimin e pajisjes.
Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike, pajisja rikthehet në SabbathMode.

Gjendja e pajisjes

Shënim

Kjo pajisje mban certifikimin e institutit "Institute for Science and Halacha". (www.machonhalacha.co.il)

Një listë të pajisjeve të certifikuara nga STAR-K e gjeni në www.star-k.org/appliances.

Aktivizimi i SabbathMode



PARALAJMËRIM

Rrezik helmimi nga ushqimi i prishur!

Nëse keni aktivizuar SabbathMode dhe ndodh një ndërprerje e energjisë elektrike, në treguesin e statusit nuk shfaqet asnjë mesazh për ndërprerjen e energjisë elektrike. Pasi ndërprerja e energjisë elektrike të ketë përfunduar, pajisja vazhdon sërish punën në SabbathMode. Për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike ushqimet mund të prishen dhe konsumimi i tyre mund të shkaktojë helmim nga ushqimi.

Pas një ndërprerjeje të energjisë elektrike:

- ▶ Mos konsumi ushqimet që kanë qenë të ngrira dhe janë shkrirë.



Fig. 29




Fig. 30

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ SabbathMode është aktivizuar.
- ▶ Treguesi i statusit tregon pa ndërprerje SabbathMode.

Çaktivizimi i SabbathMode

Modaliteti SabbathMode çaktivizohet automatikisht pas 80 orësh. Megjithatë, ju mund ta çaktivizoni modalitetin SabbathMode edhe manualisht në çdo kohë:




Fig. 31

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ SabbathMode është çaktivizuar.



EnergySaver

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni modalitetin e kursimit të energjisë. Kur aktivizoni modalitetin e kursimit të energjisë, konsumi i energjisë ulet dhe temperatura në pajisje rritet. Ushqimet qëndrojnë të freskëta, por kohëzgjatja e ruajtjes së tyre shkurtrohet.

Zona temperaturës e Cilësimi rekomanduar (shihni Vendosja e temperaturës)	Temperatura me EnergySaver aktiv
-18°C	-16 °C

Temperaturat

Aktivizimi i EnergySaver



Fig. 32




Fig. 33

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ Modaliteti i kursimit të energjisë aktivizohet.

Çaktivizimi i EnergySaver



Fig. 34




Fig. 35

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Modaliteti i kursimit të energjisë çaktivizohet.

Niveli i dritës së ekranit

Me këtë funksion ju rregulloni në mënyrë graduale nivelin e dritës së ekranit.

Ju mund të vendosni nivelet e mëposhtme të dritës:

- 40 %
- 60 %
- 80 %
- 100% (Cilësimi i paracaktuar)

Vendosja e nivelit të dritës



Fig. 36




Fig. 37 Shembull ilustrues: Ndërrimi nga 80% në 60%.

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Niveli i dritës do të vendoset.

Alarmi i derës

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni alarmin e derës. Alarmi i derës bie kur dera mbahet hapur shumë gjatë. Në gjendjen e dërgimit, alarmi i derës është i aktivizuar. Ju mund të vendoseni sesa gjatë lejohet të qëndrojë hapur dera, derisa të bjerë alarmi i derës.

Ju mund të vendosni vlerat e mëposhtme:

- 1 minutë
- 2 minuta
- 3 minuta
- Fikur

Vendosja e alarmit të derës



Fig. 38




Fig. 39 Shembull ilustrues: Ndërrimi i alarmit të derës nga 1 minutë në 3 minuta.

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Alarmi i derës vendoset.

Çaktivizimi i alarmit të derës



Fig. 41




Fig. 42

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Alarmi i derës çaktivizohet.

Bllokimi i panelit

Me këtë funksion ju aktivizoni ose çaktivizoni bllokimin e panelit. Bllokimi i panelit parandalon përdorimin pa dashje të pajisjes, p.sh. nga fëmijët.

Përdorimi:

- Shmangni ndryshimin pa qëllim të funksioneve.
- Shmangni fikjen pa qëllim të pajisjes.
- Shmangni rregullimin pa qëllim të temperaturës.

Aktivizimi i bllokimit të panelit

Nëse aktivizoni bllokimin e panelit, atëherë ju mund të navigoni më tutje nëpër meny, por nuk mund të zgjidhni apo të ndryshoni funksionet e tjera.




Fig. 43




Fig. 44

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- Bllokimi i panelit do të aktivizohet.

Përdorimi

Çaktivizimi i bllokimit të panelit



Fig. 45




Fig. 46

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Bllokimi i panelit do të çaktivizohet.



Gjuha

Me këtë funksion ju vendosni gjuhën e afishimit.

Ju mund të vendosni gjuhët e mëposhtme:

- Gjermanisht
- Anglisht
- Frëngjisht
- Spanjisht
- Italisht
- Holandisht
- Çekisht
- Polonisht
- Portugalisht
- Bullgarisht
- Rusisht
- Kinezisht

Vendosja e gjuhës



Fig. 47




Fig. 48 Shembull ilustrues sipas gjuhës dhe temperaturës

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Gjuha do të vendoset.
- ▷ Ekranet kthehen pas tek treguesi i statusit.



Informacioni i pajisjes

Me këtë funksion ju shikoni emrin e modelit, indeksin, numrin e serisë dhe numrin e shërbimit të pajisjes suaj. Informacionet e pajisjes ju nevojiten kur kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 10.4 Shërbimi për klientin)

Me këtë funksion hapni gjithashtu menyën e zgjeruar. (shihni 3 Mënyra e funksionimit të ekranit Touch & Swipe)

Shikimi i informacioneve të pajisjes



Fig. 49



Fig. 50

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Ekranet tregojnë informacionet e pajisjes.



Software

Me këtë funksion ju shikoni versionin e softuerit të pajisjes suaj.

Shikimi i versionit të softuerit



Fig. 51



Fig. 52

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▷ Ekranet tregojnë versionin e softuerit.



Modaliteti i demonstrimit

Modaliteti i demonstrimit është një funksion i veçantë për shitësit, që të mund të prezantojnë funksionet e pajisjes. Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit, atëherë të gjitha funksionet teknike të ftohjes çaktivizohen.

Nëse kur ndizni pajisjen shfaqet një "Demo" tek treguesi i statusit, kjo tregon se modaliteti i demonstrimit është aktivizuar më parë.

Nëse e aktivizoni modalitetin e demonstrimit dhe pastaj e çaktivizoni përsëri, pajisja rikthehet në cilësimet e fabrikës. (shihni Rikthimi në cilësimet nga fabrika)

Aktivizimi i modalitetit të demonstrimit



Fig. 53




Fig. 54

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ Modaliteti i demonstrimit aktivizohet.
- ▶ Pajisja është fikur.
- ▶ Ndizni pajisjen. (shihni 4.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))
- ▶ Tek treguesi i statusit shfaqet "DEMO".

Çaktivizimi i modalitetit të demonstrimit



Fig. 55




Fig. 56

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ Modaliteti i demonstrimit çaktivizohet.
- ▶ Pajisja është fikur.
- ▶ Ndizni pajisjen. (shihni 4.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))
- ▶ Pajisja rikthehet në cilësimet nga fabrika.



Rikthimi në cilësimet nga fabrika

Me këtë funksion ju i ktheni në cilësimet nga fabrika të gjitha rregullimet. Të gjitha rregullimet që keni kryer deri në atë moment, do të rikthehen në cilësimin e tyre fillestar.

Ekzekutimi i rikthimit në gjendjen fillestare



Fig. 57




Fig. 58

- ▶ Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.
- ▶ Pajisja rikthehet në gjendjen fillestare.
- ▶ Pajisja fiket.
- ▶ Rindizni pajisjen. (shihni 4.1 Ndezja e pajisjes (Vënia në punë herën e parë))

7.3 Mesazhet






Ka dy kategori të mesazheve:

Kategoria	Kuptimi
Paralajmërim	Paralajmërimet shfaqen në rastin e alarmit të derës ose në rast problemesh në funksionim. Paralajmërimet e thjeshta mund t'i mënjaroni edhe vetë. Për problemet e rënda në funksionim duhet të kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 10.4 Shërbimi për klientin)
Kujtesë	Kujtesat kujtojnë për proceset e përgjithshme. Ju mund t'i ekzekutoni këto procese dhe kështu të mënjaroni mesazhin.

7.3.1 Përmbledhje e paralajmërimeve

Sjellja e pajisjes në rastin e paralajmërimeve:

- Paralajmërimi shfaqet në ekran në ngjyrë të kuqe.
- Tingulli i alarmit bie me një volum në rritje.
- Në disa paralajmërimet pulson edhe ndriçimi i brendshëm.

Mesazhi	Shkaku	Mënjanimi i mesazhit
 Alarmi i derës	Mesazhi shfaqet kur dera mbahet hapur shumë gjatë.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Alarmi i derës)
 Alarmi për ndërprerjen e energjisë elektrike		
 Alarmi temperaturës	Mesazhi shfaqet kur temperatura e ngrirjes nuk përputhet me temperaturën e vendosur.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Alarmi i temperaturës)
 Gabim	Mesazhi shfaqet kur ndodh një gabim në pajisje. Një pjesë e pajisjes shfaq një defekt.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Gabim)
 Gabim i WLAN	Mesazhi shfaqet kur pajisja nuk ka mundur të lidhet me rrjetin WLAN. (shihni Realizimi i lidhjes me WLAN herën e parë) Mesazhi shfaqet vetëm gjatë konfigurimit të parë.	Kryeni hapat e veprimit. (shihni Gabim i WLAN)

7.3.2 Mënjanimi i paralajmërimeve

Alarmi i derës




Fig. 59 Shembull ilustrues

- Kryeni hapat e veprimeve siç tregohet në figurë.

-ose-

- Mbyllni derën.

- Ekranin kapërcen tek treguesi i statusit.

Ju mund të vendoseni sesa gjatë lejohet të qëndrojë hapur dera, derisa të bjerë alarmi i derës. (shihni Vendosja e alarmit të derës)

Alarmi për ndërprerjen e energjisë elektrike

Pasi ndërprerja e energjisë elektrike të ketë përfunduar, pajisja ftoh sërish në temperaturën e synuar të vendosur më parë, pa qenë nevoja që ta konfirmoni mesazhin. Por që mesazhi të zhduket nga ekranin, duhet ta konfirmoni atë.




Fig. 60 Shembull ilustrues

- Prekni shkurt ekranin.
- Ekranin tregon informacionet për paralajmërimin.
- Prekni shkurt ekranin.
- Tregohet temperatura më e ngrohtë e ngrirjes.
- Nëse temperatura e ngrirjes ka qenë nën -9 °C: Ushqimet mund të konsumohen më tej.
Nëse temperatura e ngrirjes është rritur mbi -9 °C:
- Kontrolloni ushqimet.
- Prekni shkurt ekranin.
- Ekranin kapërcen tek treguesi i statusit: Tregohet temperatura aktuale dhe temperatura e synuar.

Alarmi i temperaturës

Shkaku për diferencën e temperaturës mund të jetë:

- Keni futur në frigorifer ushqim të freskët të ngrohtë.
- Gjatë sistemimit dhe marrjes së ushqimeve, brenda ka qarkulluar shumë ajër i ngrohtë nga dhoma.
- Është ndërprerë energjia elektrike për kohë të gjatë.
- Pajisja është me defekt.
- Eliminoni shkaku.
- Pajisja ftoh në temperaturën e synuar të vendosur më parë.




Fig. 61 Shembull ilustrues

- ▶ Prekni shkurt ekranin.
- ▶ Ekranin tregon informacionet për paralajmërimin.
- ▶ Prekni shkurt ekranin.
- ▶ Tregohet temperatura më e ngrohtë e ngrirjes.
- ▶ Nëse temperatura e ngrirjes ka qenë nën $-9\text{ }^{\circ}\text{C}$: Ushqimet mund të konsumohen më tej.
- ▶ Nëse temperatura e ngrirjes është rritur mbi $-9\text{ }^{\circ}\text{C}$:
- ▶ Kontrolloni ushqimet.
- ▶ Prekni shkurt ekranin.
- ▶ Ekranin kapërcen tek treguesi i statusit: Tregohet temperatura aktuale dhe temperatura e synuar.

Gabim




Fig. 62 Shembull ilustrues

- ▶ Prekni shkurt ekranin.
- ▶ Do të shfaqet kodi i gabimit.
- ▶ Mbani shënim kodin e gabimit.
- ▶ Prekni shkurt ekranin.
- ▶ Ekranin kapërcen tek treguesi i statusit.
- ▶ Kontakttoni me shërbimin për klientin. (shihni 10.4 Shërbimi për klientin)

Gabim i WLAN

- ▶ Kontrolloni lidhjen me rrjetin WLAN.
- ▶ Lidhni pajisjen nga e para me rrjetin WLAN. (shihni WLAN)

7.3.3 Përmbledhje e kujtesave

Sjellja e pajisjes në rastin e kujtesave:

- Kujtesa shfaqet në ekran në ngjyrë të verdhë.
- Bie tingulli i alarmit.
- Në disa kujtesa pulson edhe ndriçimi i brendshëm.

Ju mund të çaktivizoni rikujtesat e mëposhtme :

8 Pajisjet

8.1 Sirtarët

Ju mund t'i hiqni sirtarët për t'i pastruar ata.

Ju mund t'i hiqni sirtarët, që të përdorni VarioSpace.

Heqja dhe vendosja e sirtarëve ndryshon sipas sistemit të tërheqjes. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

Shënim

- ▶ Konsumi i energjisë rritet dhe performanca e ftohjes zvogëlohet kur qarkullimi i ajrit nuk mjafton.
- ▶ Lëreni të vendosur në pajisje sirtarin më të poshtëm.
- ▶ Mbani gjithmonë të lira kanalet e ajrit të ventilatorit brenda në faqen e pasme.

8.1.1 Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë

Sirtari lëviz direkt mbi brinjën e kutisë. Këtu nuk ka asnjë shinë.

Heqja e sirtarit




Fig. 63

- ▶ Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.
- ▶ Ngrini lart sirtarin në pjesën përpara. Fig. 63 (1)
- ▶ Hiqeni sirtarin nga përpara. Fig. 63 (2)

Vendosja e sirtarit




Fig. 64

- ▶ Vendosni sirtarin pjerrtas prapa ndaluesve mbi brinjën e kutisë. (shihni Fig. 64)
- ▶ Ulni poshtë sirtarin.
- ▶ Shtyjeni sirtarin brenda për nga prapa.

8.2 Forma me kapak e kubave të akullit

8.2.1 Përdorimi i formës së kubave të akullit




Fig. 65

Kur uji është i ngrirë:

- ▶ Mbajeni formën e kubave të akullit nën ujë të ngrohtë për pak kohë.
- ▶ Hiqni kapakun.
- ▶ Rrotulloni lehtë në drejtim të kundërt cepat e formës së kubave të akullit.
- ▶ Kubat e akullit lirohen.

8.2.2 Zbërthimi i formës së kubave të akullit

Forma e kubave të akullit mund të zbërthehet për ta pastruar.

Mirëmbajtja




Fig. 66

► Zbërtheni formën e kubave të akullit.

9 Mirëmbajtja

9.1 Çmontimi / montimi i sistemit me tërheqje

9.1.1 Shënime për zbërthimin

Ju mund t'i zbërtheni disa sisteme me tërheqje për t'i pastruar. Pajisja juaj mund të ketë sisteme të ndryshme me tërheqje/zgjatje.

Sistemet më tërheqje në vijim janë të çmontueshëm ose jo të çmontueshëm:

Sistemi me tërheqje	i çmontueshëm / jo i çmontueshëm
Kaseta me hapje të plotë	jo i çmontueshëm
Sirtari me xham me dalje të plotë jashtë	i çmontueshëm
Sirtari me hapje të plotë në koshin me tërheqje	i çmontueshëm
Pjesa e ftohjes me dalje të pjeshme jashtë	jo i çmontueshëm
Pjesa e ngrirjes me dalje të pjeshme jashtë	i çmontueshëm
Sirtari i drejtuar mbi pllakën e xhamit	i çmontueshëm
Koshi me tërheqje	i çmontueshëm (shihni 9.1.2 Koshi me tërheqje)
Sirtari i drejtuar në brinjën e kutisë	jo i çmontueshëm

9.1.2 Koshi me tërheqje

Ju mund t'i hiqni sirtarët dhe mbajtësen e madhe për t'i pastruar.




Fig. 67 Shembull ilustrues

(1) Sirtari i sipërm

(2) Sirtari i mesit

(3) Kutia

Heqja e sirtarit

Secilin nga sirtarët në koshin me tërheqje mund ta hiqni në të njëjtën mënyrë.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

Sirtari është i zbrazur.

Koshi me tërheqje është tërhequr jashtë deri në fund.




Fig. 68 Shembull ilustrues

► Tërhiqni sirtarin jashtë deri në fund.




Fig. 69 Shembull ilustrues

- ▶ Tërhiqni sirtarin mbrapa nga lart.
- ▷ Sirtari lirohet nga shinat.




Fig. 70 Shembull ilustrues

- ▶ Nxirreni jashtë diagonalisht sirtarin nga përpara.
- ▷ Sirtari është hequr.

Heqja e kutisë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Koshi me tërheqje është tërhequr jashtë deri në fund.
- Sirtarët janë të futur brenda.





Fig. 71 Shembull ilustrues

- ▶ Ngrini nga përpara kutinë.
- ▶ Nxirreni kutinë jashtë diagonalisht nga përpara.

Vendosja e kutisë

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Koshi me tërheqje është tërhequr jashtë deri në fund.
- Sirtarët janë të futur brenda.




Fig. 72 Shembull ilustrues

- ▶ Vendosni kutinë mbi shinat djathtas dhe majtas.
- ▶ Uleni kutinë nga përpara, në mënyrë që të puthitet mbi shinat djathtas dhe majtas.
- ▶ Kutia është fiksuar mirë në koshin me tërheqje.

Vendosja e sirtarit

Secilin nga sirtarët në koshin me tërheqje mund ta vendosni në të njëjtën mënyrë.

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Koshi me tërheqje është tërhequr jashtë deri në fund.




Fig. 73 Shembull ilustrues

- ▶ Tërhiqni jashtë shinat.




Fig. 74 Shembull ilustrues

- ▶ Vendoseni sirtarin pjerrtas nga lart mbi shina.
- ▶ Uleni sirtarin nga përpara.
- ▶ Shtypeni sirtarin për poshtë nga përpara.
- ▶ Sirtari mbërthehet në vend.




Fig. 75 Shembull ilustrues

- ▶ Shtyjeni sirtarin deri në fund drejt pjesës së përparme të kosit me tërheqje.
- ▶ Shtyni brenda sirtarin me kujdes.

9.2 Shkrija e pajisjes

9.2.1 Shkrija me NoFrost

Shkrija kryhet automatikisht nëpërmjet sistemit NoFrost. Lagështia precipiton vetë mbi serpentinë, shkrihet dhe avullon në mënyrë periodike.

Pajisja nuk duhet shkrire.

9.3 Pastrimi i pajisjes

9.3.1 Parapërgatitja



PARALAJMËRIM

Rrezik nga goditja elektrike!

- ▶ Hiqni spinën e frigoriferit ose ndërpritni furnizimin me energji elektrike.



PARALAJMËRIM

Rrezik zjarri

- ▶ Mos dëmtoni qarkun e ftohjes.

- ▶ Zbrazni pajisjen.
- ▶ Hiqni spinën elektrike.

9.3.2 Pastrimi i hapësirës së brendshme

KUJDES

Pastrimi i gabuar!

Dëmtime në pajisje.

- ▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
- ▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
- ▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

- ▶ Sipërfaqet plastike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
- ▶ Sipërfaqet metalike: pastrojini me dorë me një pecetë të butë e të pastër, me ujë të vakët dhe pak detergjent enësh.
- ▶ Vrima e shkarkimit: hiqni papastërtitë e grumbulluara me një mjet ndihmës të hollë, p.sh. me kunj për veshët.

9.3.3 Pastrimi i pjesëve

KUJDES

Pastrimi i gabuar!

Dëmtime në pajisje.

- ▶ Përdorni vetëm peceta pastrimi të buta dhe pastrues të përgjithshëm me vlerë pH neutrale.
- ▶ Mos përdorni sfungjer gërryes ose gërvishtës ose lesh teli metalik.
- ▶ Mos përdorni asnjë mjet pastrimi të mprehtë, gërryes, që përmban rërë, klorur ose acid.

Pastrimi me një pecetë të butë e të pastër, ujë të vakët dhe pak detergjent:

- Sirtari

Pastrimi me pecetë të lagësht:

- Shinat teleskop
Mbani parasysh: Grasoja në shinat e rrëshqitjes shërben për lubrifikimin dhe nuk duhet fshirë!

Pastrimi në larëse enësh deri në 60 °C:

- Forma e kubave të akullit
- ▶ Zbërthimi i pjesëve: shihni kapitullin përkatës.
- ▶ Pastroni pjesët.

9.3.4 Pas pastrimit

- ▶ Thani pajisjen dhe pjesët përshtatëse duke i fërkuar.
- ▶ Lidhni pajisjen dhe ndizeni.
- ▶ Aktivizoni funksionin SuperFrost (shihni 7.2 Funksionet e pajisjes).
Kur temperatura të jetë mjaftueshëm e ftohtë:
- ▶ Futni ushqimet.
- ▶ Përsëritni pastrimin rregullisht.

10 Ndihma për klientin

10.1 Të dhënat teknike

Diapazoni i temperaturave	
Ngrirja	-28 °C deri në -15 °C

Sasia maksimale e ngrirjes / 24 orë	
Dhoma e ngrirjes	Shihni etiketën e parametrave të „Kapaciteti i ngrirjes .../ 24 h“

Ndriçimi	
Klasa e efiçencës së energjisë ¹	Burimi i dritës
Ky produkt përmban një ose më shumë burime drite të klasës së efiçencës së energjisë "G".	LED

¹ Pajisja mund të ketë burime drite me klasa të ndryshme të efiçencës së energjisë. Këtu jepet klasa e efiçencës më të ulët të energjisë.

Për pajisjet me lidhje Wi-Fi:

Ndihma për klientin

Të dhënat e frekuencave	
Brezi i frekuencave	2,4 GHz
Fuqia maksimale e rrezatuar	< 100 mW
Qëllimi i përdorimit i pajisjes me radiovalë	Lidhja në rrjetin lokal Wi-Fi për komunikimin e të dhënave

10.2 Zhurmat gjatë punës

Pajisja shkakton nivele të ndryshme zhurme gjatë funksionimit të saj.

- Në **performancë të ulët ftohjeje** pajisja punon duke kursyer energji, por punon më gjatë. Niveli i zhurmës është më **i ulët**.
- Në **performancë të lartë ftohjeje** ushqimet ftohen më shpejt. Niveli i zhurmës është më **i lartë**.

Shembuj:

- funksionet e aktivizuara (shihni 7.2 Funksionet e pajisjes)
- ventilatori që punon
- ushqimi i vendosur i freskët
- temperatura e lartë e ambientit
- dera e mbajtur hapur gjatë

Zhurma	Shkaku mundshëm	Lloji i zhurmës
Zhurme qarkullimi dhe gurgullime	Agjenti ftohës qarkullon në qarkun e ftohjes.	Zhurme normale pune
Fërshëllimë dhe shfryrje	Agjenti ftohës injektohet në qarkun e ftohjes.	Zhurme normale pune
Gumëzhimë	Pajisja është duke ftohur. Niveli i zhurmës varet performanca e ftohjes.	Zhurme normale pune

Zhurma	Shkaku mundshëm	Lloji i zhurmës
Zukatje fëshfërimë dhe	Ventilatori është duke punuar.	Zhurme funksionimi normale
Klikim	Komponentët ndizen dhe fiken.	Zhurme veprimi normale
Kërcitje zukamë ose	Valvulat ventilet aktive ose janë	Zhurme veprimi normale

Zhurma	Shkaku mundshëm	Lloji i zhurmës	Mënyrimi
Dridhje	Instalimi i papërshtatshëm	Zhurme gabimi	Kontrolloni instalimin. Niveloni pajisjen.
Kërcitje	Pajisjet, Objektet në brendësi të pajisjes	Zhurme gabimi	Fiksoni pjesët e pajisjeve. Lini distancë midis objekteve brenda.

10.3 Defektet teknike

Pajisja juaj është projektuar dhe prodhuar në mënyrë të tillë që të garantohet siguria e funksionimit dhe jetëgjatësia e madhe. Por megjithatë kur gjatë përdorimit shfaqet një problem, verifikoni nëse problemi është shkaktuar si rezultat i një gabimi në përdorim. Në këtë rast, duhet të merrni në konsideratë kostot e riparimit, edhe gjatë periudhës së garancisë.

Problemet që jepen në vijim mund t'i eliminoni vetë.

10.3.1 Funksioni i pajisjes

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
Pajisja nuk punon.	→ Pajisja nuk është e ndezur.	▶ Ndizni pajisjen.
	→ Spina nuk është futur saktë në prizën elektrike.	▶ Kontrolloni spinën.
	→ Siguresa në prizën elektrike nuk është në rregull.	▶ Kontrolloni siguresën.
	→ Shkëputje e energjisë elektrike	▶ Mbani të mbyllur pajisjen. ▶ Mbrojtja e ushqimeve: Shtroni pllakat ftohëse lart mbi ushqime ose përdorni një pajisje tjetër ngrirëse, nëse shkëputja e energjisë elektrike zgjat shumë. ▶ Mos i ngrini përsëri ushqimet e shkrira.
	→ Fisha e frigoriferit nuk është futur mirë në pajisje.	▶ Kontrolloni fishën e frigoriferit.
Temperatura nuk është mjaftueshëm e ftohtë.	→ Dera e pajisjes nuk është e mbyllur siç duhet.	▶ Mbyllni derën e pajisjes.
	→ Qarkullimi i ajrit dhe ajrimi nuk është i mjaftueshëm.	▶ Mbani të lirë dhe pastroni rrjetën e ajrimit.

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
	→ Temperatura e ambientit është shumë e lartë.	► Zgjidhja e problemit: (shihni 1.2 Klasat e klimës)
	→ Pajisja është hapur shumë shpesh ose për kohë të gjatë.	► Pritni për të parë nëse temperatura e kërkuar do të rivendoset vetvetiu. Nëse jo, kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 10.4 Shërbimi për klientin)
	→ Janë futur sasi shumë të mëdha ushqimi të freskët pa funksionin SuperFrost.	► Zgjidhja e problemit: (shihni SuperFrost)
	→ Temperatura është vendosur gabim.	► Vendosni temperaturë më të ftohtë dhe kontrolloni pas 24 orësh.
	→ Pajisja ndodhet shumë pranë një burimi nxehtësie (sobë, kalorifer etj.).	► Ndryshoni vendin e pajisjes ose të burimit të nxehtësisë.
	→ Pajisja nuk është instaluar saktë brenda në dollap.	► Kontrolloni nëse pajisja është instaluar në rregull dhe që dera mbyllet si duhet.

10.3.2 Pajisjet

Gabimi	Shkaku	Zgjidhja
Ndriçimi i brendshëm nuk ndizet.	→ Pajisja nuk është e ndezur.	► Ndizni pajisjen.
	→ Dera është mbajtur hapur më gjatë se 15 minuta.	► Ndriçimi i brendshëm fiket automatikisht pas 15 minutash kur dera e pajisjes është e hapur.
	→ Ndriçimi LED ka defekt ose kapaku i tij është dëmtuar.	► Kontaktoni me shërbimin për klientin. (shihni 10.4 Shërbimi për klientin)

10.4 Shërbimi për klientin

Fillimisht provoni nëse mund ta eliminoni vetë defektin (shihni 10 Ndhim për klientin). Nëse nuk ia dilni dot, kontaktoni me shërbimin për klientin.

Adresën e gjeni në broshurën bashkëlidhur „Shërbimi i Liebherr“ ose në faqen e internetit home.liebherr.com/service.



PARALAJMËRIM

Riparim jo profesional!
Lëndime.

- Riparimet dhe ndërhyrjet në pajisje dhe në kordonin e lidhjes elektrike, të cilat nuk përmenden në mënyrë specifike (shihni 9 Mirëmbajtja), duhen kryer vetëm nga kujdesi për klientin.
- Ndërroni kordonin e dëmtuar të lidhjes elektrike vetëm te prodhuesi ose nga shërbimi i tij për klientin ose te një person me kualifikim të ngjashëm.
- Në pajisjet me spinë frigoriferi, ndërrimi lejohet të bëhet nga klienti.

10.4.1 Kontakti me shërbimin për klientin

Sigurohuni që keni gati informacionet e mëposhtme të pajisjes:

- Emërtimi i pajisjes (Modeli dhe indeksi)
- Nr. i shërbimit (Shërbimi)
- Numri i serisë (S-Nr.)

► Hapni informacionet e pajisjes nëpërmjet ekranit. (shihni Informacioni i pajisjes)

-ose-

- Merrni informacionet e pajisjes nga etiketa e parametrevë. (shihni 10.5 Etiketa e parametrevë)
- Mbani shënim informacionet e pajisjes.
- Njoftoni shërbimin për klientin: Komunikojini defektin dhe informacionet e pajisjes.
- Kjo bën të mundur një shërbim të shpejtë dhe të fokusuar.
- Ndiqni instruksionet e tjera të shërbimit për klientin.

10.5 Etiketa e parametrevë

Etiketa e parametrevë ndodhet poshtë në anën e brendshme të pajisjes.




Fig. 76

- (1) Emërtimi i pajisjes
 - (2) Nr. i shërbimit
 - (3) Numri i serisë
- Lexoni informacionet e etiketës së parametrevë.

11 Nxjerrja jashtë pune

- Zbrazni pajisjen.
- Fikni pajisjen. (shihni Fikja dhe ndezja e pajisjes)
- Hiqni spinën elektrike nga priza elektrike.

Hedhja

- ▶ Nëse nevojitet, hiqni fishën e frigoriferit: Nxirrni fishën e frigoriferit nga priza në pajisje dhe njëkohësisht lëvizeni majtas dhe djathtas.
- ▶ Pastroni pajisjen. (shihni 9.3 Pastrimi i pajisjes)
- ▶ Lëreni derën hapur që të mos krijohen erëra të këqija.

12 Hedhja

Sigurohuni që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- Kuptimi i simboleve në pajisje është i njohur. (shihni 1.14 Simbolet në pajisje)
- Udhëzimet për mënjanimin janë të njohura. (shihni 1.8 Hedhja)

12.1 Përgatitja e pajisjes për mënjanimin

- ▶ Nxirrni pajisjen jashtë pune. (shihni 11 Nxjerrja jashtë pune)

12.2 Hedhja e pajisjes në mënyrë ekologjike



PARALAJMËRIM

Gaz ftohës dhe vaj që del jashtë!

Zjarr. Gazi ftohës i pajisjes është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Vaji që përmban pajisja është miqësor ndaj mjedisit, por i ndezshëm. Gazi ftohës dhe vaji që rrjedh jashtë mund të marrë flakë në rast përqendrimit të lartë përkatës dhe në kontakt me një burim nxehtësie të jashtëm.

- ▶ Mos dëmtoni tubacionet e qarkut të gazit ftohës dhe kompresorin.
-

- ▶ Ndiqni udhëzimet për transportin e pajisjes.
- ▶ Transportoni pajisjen pa e dëmtuar atë.
- ▶ Hidheni pajisjen sipas udhëzimeve.



home.liebherr.com/fridge-manuals

sq Frigoriferët ftohës dhe ngrirës me mundësi instalimi nën banak, me kosh me tërheqje

Data e botimit: 20260213

**Indeksi i nr. të
artikullit: 7083748-00**

Liebherr-Hausgeräte GmbH
Memminger Straße 77-79
88416 Ochsenhausen
Deutschland